

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR VITIN 2007

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe me nenin 28 pika 3 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2007, si dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, konstaton se:

- Veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Kuvendi, duke njohur rolin e këtij institucioni për sigurimin e depozitave të shtetasve, të vendosura në institucionet bankare që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, vlerëson pozitivisht veprimtarinë e këtij institucioni në drejtim të:

- administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, nëpërmjet investimit të tyre në depozita pranë Bankës së Shqipërisë, letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare apo në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare;

- harmonizimit të kuadrit rregullator të agjencisë, në përputhje me rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë për planin e kontingjencës;

- aplikimit të teknologjive bashkëkohore që lehtësojnë drejtimin e agjencisë dhe përmbushjen e misionit të saj;

- edukimit dhe informimit të publikut, me qëllim funksionimin në mënyrë efektive të sistemit.

Kuvendi kërkon që për vitin 2008, midis të tjerave, agjencia të përqendrojë punën edhe në këto drejtime:

- përshpejtimin e procedurave për përmirësimin e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

- rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së institucionit, nëpërmjet njohjes e zbatimit të direktivave të BE-së dhe të praktikave ndërkombëtare të përparuara të skemave të sigurimit të depozitave;

- rritjen e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, në drejtim të saktësisë së përllogaritjes së primit dhe vlerësimit të gjendjes financiare të institucioneve bankare, të siguruara pranë agjencisë.

26 maj 2008